

DITARI MUJOR **MARS 2025**



NIS SHPERNDARJA E BONUSIT TË PRANVERËS

Qeveria Shqiptare ka nisur shpërndarjen e Bonusit të Pranverës nga 3 Marsi 2025, duke përmbyshur një tjetër premtim.

Përfitues janë 730,430 pensionistë, të cilët mund ta tërheqin shumën pranë Postës Shqiptare dhe bankave. Pensionet bazë deri në 20,000 lekë marrin një bonus prej 10,000 lekësh, ndërsa ato mbi këtë kufi përfitojnë 5,000 lekë.

Afati i fundit për tërheqje është 30 Shtator 2025. Po ashtu, pensionistët që ende nuk kanë tërhequr Bonusin e Fundvitit mund ta bëjnë këtë deri më 30 Qershor 2025.

PANAIRI SHQIPTAR I PUNËS “PUNO & JETO ATY KU KE ZEMRËN”



Panairi Shqiptar i Punës “Puno & Jeto aty ku ke zemrën” ofroi mundësi konkrete për punësim dhe karrierë në Shqipëri, duke krijuar një hapësirë ku talenti takohet me mundësitë.

Eventi u zhvillua në Technopolis City (Gazi), pranë stacionit të metrosë Kera-mikos, Athinë, me praninë e Kryeministrit Edi Rama, zëvendëskryeministres Belinda Balluku dhe disa ministrave.

Mbi 120 biznese shqiptare prezantuan ofertat e tyre të punës, ku për 40% të profesioneve pagat variojnë nga 1,000 deri në 6,000 euro.

SHQIPËRIA PJESËMARRËSE SI VENDI MIKPRITËS NË ITB BERLIN 2025

Shqipëria shkëlqeu në ITB Berlin 2025 si vendi mikpritës, duke prezantuar kulturën dhe turizmin përmes artit imersiv, diskutimeve strategjike dhe performancave artistike.

U theksua zhvillimi i turizmit përmes lidhjeve ajrore, transformimit digjital dhe promovimit si destinacion premium.

Pjesëmarrja e trupave artistike dhe prezantimi inovativ i traditës forcuan identitetin kulturor shqiptar në skenën ndërkombëtare.



MIRATOHET MARRËVESHJA PËR NJOHJEN E KONTRIBUTEVE TË SIGURIMEVE SHOQERORE MES SHQIPËRISË DHE ITALISË

Senati italian ka miratuar marrëveshjen për njohjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore mes Shqipërisë dhe Italisë, një hap historik pas 15 vitesh negociata. Kjo marrëveshje siguron të drejtat për pensionet e mijëra punonjësve shqiptarë në Itali dhe italianëve në Shqipëri, duke garantuar që asnjë vit pune të mos humbasë. Ajo ofron siguri dhe perspektivë të re për 550 mijë shqiptarë dhe 4 mijë italianë, duke përfshirë përfitime për pension pleqërie, invaliditeti, familjar, sëmundjet dhe papunësinë.



SHQIPËRIA, NJË QENDËR STRATEGJIKE INOVACIONI DHE TEKNOLOGJIE

Shqipëria po pozicionohet si një qendër strategjike inovacioni dhe teknologjie, duke ndërtuar një ekonomi të qëndrueshme dhe konkurruese me investime në AI, Cloud dhe infrastrukturën digjitale, duke krijuar mundësi të reja për sipërmarrjet dhe të rinjtë.

Bashkëpunimi me Francën dhe ekspertiza e Inetum po udhëheqin këtë transformim historik, duke siguruar përgatitjen e Shqipërisë për sfidat dhe mundësitë e epokës digjitale përmes politikave vizionare dhe transparente.

Ky angazhim ka si qëllim zhvillimin e vendit dhe pozicionimin e Shqipërisë si lider rajonal, gjithnjë e më pranë Bashkimit Europian.

AULON NAÇI, DREJTORI I RI I TEATRIT TË OPERAS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR

Drejtorit të ri të Teatrit Kombëtar të Operas, Balletit dhe Ansambilit Popullor, z. Aulon Naçi, i urojmë suksese në këtë detyrë! Z. Naçi ka një karrierë të pasur në muzikë dhe kompozicion, duke studiuar në Konservatorin "J. Tomadini" në Itali dhe më pas specializuar në Belgjikë. Veprat e tij janë interpretuar në shumë vende, dhe ka udhëhequr aktivitete artistike me emra të njohur. Ai ka marrë çmime të ndryshme dhe ka kontribuar si këshilltar dhe pedagog në fushën e muzikës. Përzgjedhja e tij u bë pas një procesi konkurrimi të mbështetur nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.



SHPALLET THIRRJA PËR APLIKIM PËR KREDI ME 0% INTERES PËR PUNONJËSIT E ADMINISTRATËS PUBLIKE

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit ka hapur Thirrjen për Aplikim për Kredi me 0% interes për blerjen e një banese për 530 punonjës të administratës publike. Kredi ofrohet sipas çmimit të referencës dhe sipërfaqes së përcaktuar nga certifikata familjare, duke përfshirë 12 institucione.

Kriteret për aplikim janë: të jeni i punësuar në administratën publike sipas ligjit "Për strehimin social", të mos keni një banesë në pronësi ose në proces legalizimi, të mos zotëroni pasuri mbi gjysmën e vlerës së banesës që do të blihet dhe të mos keni përfituar nga programe të tjera të strehimit social.





TJETËR KAPACITET ME VLERA I SHTOHET EKIPIT DREJTUES TË MINISTRISË SË EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT!

Alkida Llakaj i është bashkuar ekipit drejtues të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, duke marrë drejtimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë. Me një përvojë 14-vjeçare në institucione publike, Alkida sjell ekspertizë në auditim, mbikëqyrje institucionale dhe përmirësimin e qeverisjes publike. E diplomuar në State University of New York dhe Universitetin e Tiranës, me një MSc në Politika dhe Qeverisje në Europë, ajo vjen me një vizion të qartë për forcimin e standardeve metrologjike dhe rritjen e transparencës institucionale.

NJË VIT SUKSESI PËR OPERATORIN E BLERJEVE TË PËRQENDRUARA (OBP)



Operatori i Blerjeve të Përqendruara (OBP) ka shënuar një vit suksesi në transformimin e prokurimit publik në Shqipëri, duke arritur 20.4 milionë euro kursime në fondet publike dhe duke përfshirë 141 institucione në prokurimin e përqendruar. OBP ka prokuruar 76% më shumë fonde dhe ka zhvilluar 46% më shumë procedura krahasuar me vitin e kaluar, duke rritur konkurrueshmërinë me një mesatare prej 4.7 operatorësh për tender. Platforma inovative Alb-Zone dhe sistemet e automatikë për njoftimin e operatorëve kanë rritur transparencën dhe menaxhimin efikas të fondeve, duke garantuar një proces prokurimi më të sigurt dhe të zgjuar.

ZHVILLOHET SESIONI INFORMUES PËR THIRRJEN E TRETË TË CHALLENGE FUND

Zëvendësministri i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, z. Sokol Duma, mori pjesë në sesionin informues për thirrjen e tretë të Challenge Fund, një program që ofron mundësi financimi për start-up-et dhe NVM-të shqiptare, duke mbështetur zgjidhje inovative në faza të ndryshme të zhvillimit. Ky takim mbledhi mbi 40 pjesëmarrës nga fusha të ndryshme si ekonomia kreative, teknologjia, artizanati dhe turizmi. Deri tani, janë akorduar 40 grante me një total prej €712,552.08, me tre kategori financimi: Ide dhe Validim, Faza e Rritjes, dhe Shkallëzim, me bashkëfinancim të ndryshëm për çdo kategori. Së bashku me #EU4Innovation, janë investuar mbi 11.7 milionë euro për të fuqizuar ekosistemin e inovacionit dhe start-up-et shqiptare.



PROGRAMI KOMBËTAR I STREHIMIT SOCIAL: ARRITJE, PRIORITETE DHE PROGRAME INVESTIMESH

Që prej vitit 2018, Shqipëria ka zbatuar 6 programe të strehimit social, duke krijuar një stok publik prej 117,823 m² dhe një fond prej mbi 35 milion euro, duke mbështetur 35,800 familje. Gjatë vitit 2025, 44 bashki kanë aplikuar për 56 projekte të reja, me 530 kuota për administratë dhe 170 apartamente për familjet e pastreha. Po ashtu, 300 banesa sociale do të ndërtohen në 8 bashki. Angazhimi për vitin 2030 është një investim prej 300 milionë euro për të mbështetur 50,000 familje, të rinj dhe emigrantë që kthehen në Shqipëri.



ZHVILLOHET PARTNERITETI DYPALËSH MES SHQIPËRISË DHE ITALISË

Në takimin me ambasadorin e ri të Italisë në Shqipëri, z. Marco Alberti, u diskutua mbi thellimin e partneritetit dypalësh në kulturë, ekonomi dhe inovacion. U theksua rëndësia e Javës Kulturore Italiane, hapja e një Qendre Shqiptare të Kulturës në Itali dhe krijimi i një Muzeu Italian në Tiranë.



Po ashtu, u trajtuan tema si pensionet, investimet dhe kualifikimet profesionale, duke riafirmuar bashkëpunimin e fortë mes dy vendeve.



MEKI PJESËMARRËSE NË TAKIMIN LANÇUES TË RAPORTIT SME POLICY INDEX PËR BALLKANIN PERËNDIMOR DHE TURQINË 2026

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit mori pjesë në takimin lancues të Raportit SME Policy Index për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2026, organizuar nga OECD në Paris. Ky raport analizon progresin ekonomik dhe mjedisin e biznesit në rajon, duke ofruar rekomandime për zhvillimin e politikave për SME-të, në përputhje me procesin e anëtarësimit në BE. MEKI, si koordinator kombëtar, do të vijojë bashkëpunimin me institucionet për të avancuar reformat dhe përmirësuar klimën e biznesit në Shqipëri.

NISIN PËRGATITJET PËR PROGRAMIN E PARTNERITETIT PËR VENDIN (PCP) 2025–2030

Takimi me përfaqësuesit e UNIDO, të kryesuar nga znj. Solomiya Omelyan, shënoi nisjen e përgatitjeve për Programin e Partneritetit për Vendin (PCP) 2025–2030, që synon zhvillimin industrial të qëndrueshëm të Shqipërisë.

Diskutimet u përqendruan në harmonizimin e prioriteteve kombëtare me vizionin e ri të UNIDO-s, thellimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe promovimin e investimeve të qëndrueshme, duke mbështetur inovacionin dhe transformimin e sektorëve strategjikë në funksion të integritetit europian të vendit.



MUZEU HEBRAIK

Ministri Blendi Gonxhja dhe Kryeministri Edi Rama vizituan zonën historike të Vlorës, ku ka nisur puna për ngritjen e Muzeut Hebraik, një projekt ambicioz me AADF.

Ky muze do të pasqyrojë historinë e komunitetit hebre të mikpritur nga shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore, ndërsa synon të shndërrohet në një qendër kulturore që frymëzon, edukon dhe bashkon komunitetin.



HAPËSIRA MEMORIALE MULTIFUNKSIONALE NË FISHTË, LEZHË, VENDLINDJA E AT GJERGJ FISHTËS, NJË QENDËR E RE KULTURORE

Hapësira Memoriale Multifunktionale në Fishtë, Lezhë, vendlindja e At Gjergj Fishtës, është një qendër e re kulturore dhe rekreative që nderon kujtesën dhe gjallëron artin e shpirtin krijues.

Kjo hapësirë do të shërbejë për rezidenca artistike e letrare, ekspozita, sesione krijuese dhe aktivitete kulturore, si pjesë e një projekti në bashkëpunim me Fondin Shqiptar të Zhvillimit, që lidh trashëgiminë me krijimtarinë e së ardhmes.



“PAKETA E MALEVE”

Në Shkodër, ministri Gonxhja së bashku me Kryeministrin Rama dhe Ministrin Arbjan Mazniku, prezantuan “Paketën e Maleve”, një ligj që lidh të drejtën zakonore me atë ligjore, duke thjeshtuar procedurat për legalizimin dhe investimin në tokat e trashëguara brez pas brezi.

Për 500 sipërmarrësit e parë, investimet do të kenë taksa dhe TVSH zero për 10 vjet, duke nxitur zhvillimin ekonomik dhe rikthimin e diasporës.



AUTOMOTIVE FAIR ALBANIA RIKTHEHET ME EDICIONIN E TIJ TË TRETË!

Nga 27-30 Mars, në sheshin “Nënë Tereza” dhe sheshin “Italia”, Tirana u bë epiqendra e inovacionit dhe pasionit për automobilizmin!

4 ditë spektakolare me makina unike, gara dhe spektakle për të mos u humbur!



PLANI PËR TRANSFORMIMIN E ZONËS SË METALURGJIKUT NË NJË QENDËR MODERNE TË ZHVILLIMIT INDUSTRIAL

Zona e Metalurgjikut në Elbasan do të transformohet në një qendër moderne të zhvillimit industrial, si pjesë e një strategjie të re për ringjalljen e industrisë si shtyllë kryesore të ekonomisë kombëtare. Me një masterplan gjithëpërfshirës, vizion afatgjatë dhe modele inovative financimi, kjo zonë synon të bëhet një pikë kyçe e ekonomisë dhe një burim i rëndësishëm punësimi për rajonin.



TREGU I PËRBASHKËT RAJONAL

Takimi rajonal me temë “Tregu i Përbashkët Rajonal – një rrugë e përshpejtuar drejt Integrimit Ekonomik Evropian,” i organizuar nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nën kryesimin e Tiranës të Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore, mbledhi përfaqësues nga institucionet shqiptare, Bashkimi Evropian dhe sektori privat. Aktiviteti u kryesua nga Zv. ministria e MEKI, Blerta Rama, dhe fokusi i diskutimit ishte Shtylla e Dytë e Planit të Ri të Rritjes, që synon përmirësimin e bashkëpunimit ekonomik në rajon dhe avancimin e Tregut të Përbashkët Rajonal (TPR), i hartuar sipas standardeve të BE-së. Ky plan përmban një veprimtari gjithëpërfshirëse për harmonizimin e legjislacionit rajonal me ato evropiane

dhe ka dhënë rezultate të jashtëzakonshme përmes bashkëpunimit, duke nxitur reforma të qëndrueshme rajonale. Qëllimi i takimit ishte diskutimi i mundësive dhe sfidave për përshpejtimin e integrimit ekonomik evropian të rajonit dhe mënyrat se si institucionet publike dhe bizneset mund të kontribuojnë në këtë proces. Integrimi ekonomik rajonal është një hap i rëndësishëm drejt anëtarësimit të Ballkanit Perëndimor në BE.



MBLEDHJA E PARË E KËSHILLIT KOMBËTAR TË PUNËS PËR VITIN 2025

Zv. Ministria Olta Manjani kryesoi mbledhjen e parë të Këshillit Kombëtar të Punës për vitin 2025, organit më të lartë konsultativ trepalësh, ku morën pjesë përfaqësues nga qeveria, organizatat e punëdhënësve dhe punëmarrësve. Gjatë mbledhjes u diskutuan tema të rëndësishme, si krijimi i Komitetit të Përbashkët Konsultativ me Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian, analizat vjetore të Inspektoratit të Punës dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore, draft-rregullorja e re e funksionimit të KKP-së, si dhe çështjet e propozuara nga partnerët socialë. Ky dialog trepalësh mbetet thelbësor për një treg pune më të sigurt dhe të qëndrueshëm, si dhe për përgatitjen e Shqipërisë në rrugën drejt Bashkimit Evropian.



AUTO MOTO PARK ALBANIA, PROJEKTI PËR KRIJIMIN E NJË NGA KOMPLEKSEVE MË MODERNE TË GARAVE

Auto Moto Park Albania, një projekt që po zhvillohet në Elbasan, do të jetë një nga komplekset më moderne të garave në rajon, ndërtuar sipas standardeve të FIA, me synimin ambicioz për të pritur Formula 1 deri në vitin 2030. Ky park, me kapacitet deri në 300 mijë spektatorë dhe një audiencë globale mbi 1 miliard shikues, do të sjellë një ndikim të madh në turizmin sportiv dhe ekonominë shqiptare, duke kontribuar në rritjen e punësimit, zhvillimin lokal dhe industrinë e shërbimeve dhe mikpritjes. Përveç pistës, do të ketë edhe qendrën e parë për trajnimin e sigurisë rrugore në Shqipëri, e cila do të ndihmojë në uljen e aksidenteve dhe përmirësimin e sjelljes në rrugë. Ky investim strategjik do të pozicionojë Shqipërinë në vëmendjen e industrisë globale, me ndikim të madh ekonomik dhe social.



ZHVILLOHET PANAIRI MATCH MAKER ALBANIA 2025

Një nga ngjarjet më të rëndësishme të vitit për ekonominë shqiptare, që u mbajt në Pallatin e Kongreseve, duke bashkuar mbi 500 investitorë të huaj, mbi 200 investitorë shqiptarë, dhe 30 projekte investimi, me përfaqësues nga 35 shtete të ndryshme. Gjatë këtij eventi dinamik, u zhvilluan takime B2B & B2G, panele me ekspertë ndërkombëtarë, prezantime të produkteve më të mira “Made in Albania”, si dhe aktivitete të tjera, si podcast-e live, workshop-e frymëzuese dhe ngjarje sociale e kulturore, duke shënuar një moment historik për rrjetëzimin dhe zhvillimin ekonomik të vendit.

